



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 9 mars 2020
Nr. ref.:RK1526/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI194/18

Parashtrues

Kadri Muriqi dhe Zenun Muriqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës, Rev.nr.157/2018, të 4 korrikut 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Kadri Muriqi dhe Zenun Muriqi, nga Peja (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin [Rev.nr.157/2018] e 4 korrikut 2018 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ac.nr.2743/2016] e 25 janarit 2018 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C.nr.896/12] e 18 majit 2016 të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamentit të Përgjithshëm (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesit e kërkesës e kanë pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme më 18 gusht 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes së cilit, sipas pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tyre të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) si dhe nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 14 dhjetor 2018, parashtruesit e kërkesës, përmes shërbimeve postare, e dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 20 dhjetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 18 janar 2019, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Në të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një shkresë të përbashkët njoftuese palëve të interesuara në kërkesën KI194/18, respektivisht, I.S., H.S., D.S., B.S., Gj.H., dhe A.D. Gjykata i njoftoi ata për regjistrimin e kërkesës dhe u dërgoi një kopje

të saj, duke u dhënë po ashtu mundësinë që të paraqesin komentet e tyre lidhur me kërkesën. Brenda afatit të përcaktuar, Gjykata nuk pranoi ndonjë koment nga palët e interesuara.

10. Më 11 shtator 2019, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë dosjen e plotë që ndërlidhet me kërkesën KI194/18.
11. Më 17 shtator 2019, Gjykata Themelore e dorëzoi në Gjykatë dosjen e kërkuar.
12. Më 8 nëntor 2019, Gjykata, nga dosja origjinale e dorëzuar në Gjykatë vërejti se palë e interesuar në kërkesën KI194/18 është edhe Sh.Sh., të cilin po ashtu e njoftoi për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj. Gjykata i dha mundësinë edhe kësaj pale të interesuar që të paraqesë komentet e saj lidhur me kërkesën. Gjykata u njoftua nga Posta e Kosovës se nuk kanë arritur ta lokalizojnë Sh.Sh.
13. Më 5 shkurt 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Parashtruesit e kërkesës kishin blerë një pronë të paluajtshme në vitin 2010. Më pas, në vitin 2012 ata kishin iniciuar një proces gjyqësor duke paditur fqinjët e tyre dhe duke kërkuar “mohim të servitutit dhe dorëzim të patundshmërisë”. Në vitin 2018 kishin përfunduar të gjitha procedurat gjyqësore, në të tri shkallët [Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme] lidhur me rastin e parashtruesve të kërkesës. Në vijim, të gjitha këto fakte do të shpjegohen sipas kronologjisë.

Procedurat e zhvilluara për konfirmimin e pronësisë dhe shitblerjen e pronës së paluajtshme – servitutit pranë së cilës është objekt kontesti në rastin KI194/18

15. Më 20 qershor 2008, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPCC), përmes Vendimit grupor [KPCC/D/A/19/2008] kishte vendosur që M.M.I. është pronar i vetëm i të gjithë parcelës nr.5382/4, me listë poseduese nr.9475 ZK Pejë, me sipërfaqe totale prej 500m² (në tekstin e mëtejme: prona e paluajtshme). Përmes këtij Vendimi Grupor, KPCC vendosi që: (i) M.I.M. është pronar mbi 1/1 të pronës së kërkuar; (ii) M.I.M. ka të drejtë në posedim të pronës në fjalë; (iii) palët përgjegjëse ose çdo person tjetër i cili ka uzurpuar pronën, do të dëbohet nga prona.
16. Më 18 maj 2010, parashtruesit e kërkesës e kishin blerë pronën e paluajtshme të lartcekur nga pronari i deriatëhershëm i saj, M.I.M. Në të njëjtën ditë ata e kishin vërtetuar Kontratën e shitblerjes në Gjykatën Komunale në Pejë.
17. Më 23 korrik 2010, parashtruesit e kërkesës u pajisen me Certifikatën [nr. UL-71611071-09475] mbi të drejtat e pronës së paluajtshme për pronën e paluajtshme në fjalë, në të cilën theksohej se parashtruesi i parë i kërkesës,

Kadri Muriqi është pronar i 1/2-tës së pronës së paluajtshme; ndërkaq parashtruesi i dytë i kërkesës, Zenun Muriqi është pronar i 1/2-tës tjetër të pronës së paluajtshme. Bashkërisht, parashtruesit e kërkesës, vëllezër, sipas Certifikatës në fjalë, ishin pronarë të të gjithë pronës së paluajtshme. Pronësia e tyre mbi këtë pronë, siç do të shihet më tutje, nuk ishte asnjëherë objekt kontesti para gjykatave të rregullta e as në mes të parashtruesve të kërkesës dhe palëve të interesuara. Kontestuese përgjatë gjithë procedurave, siç do të shpjegohet më tutje, ishte megja e kësaj prone me pronat fqinjësore të palëve të interesuara dhe, më konkretisht, një rrugë e cila ishte hapur si servitut për pronën e I.S. dhe të cilën e shfrytëzonin edhe fqinjët e tjerë. Kontestuese po ashtu, ishte fakti se nga cili moment është krijuar kjo rrugë dhe se a mund të shuhej/mohohej servituti në fjalë, pasi që parashtruesit e kërkesës ishin bërë pronar të pronës së paluajtshme në fjalë, ndërkohë që servitutit si i tillë pretendohet se kishte ekzistuar qysh në kohën kur M.I.M ishte pronar i pronës së paluajtshme që iu ishte shitur parashtruesve të kërkesës.

Procedurat e zhvilluara që nga momenti i paraqitjes së padisë fillestare e deri në përfundimin e 14 shqyrtimeve gjyqësore [13 shqyrtime paraprake dhe 1 shqyrtim kryesor] pranë Gjykatës Themelore

18. Më 14 nëntor 2012, parashtruesit e kërkesës fillimisht parashtruan padi për “vërtetim pronësie” kundër I.S., Gj.H., A.D., dhe F.L.L. Të njëjtën padi, më pas dhe në një datë të mëvonshme ata e kishin precizuar dhe ri-klasifikuar si “padi për mohim të servitutit dhe dorëzim të patundshmërisë”. Padinë e tyre parashtruesit e kërkesës e kishin arsyetuar duke argumentuar se ata e kanë blerë pronën e paluajtshme nga ish-pronari i saj, M.I.M., por që më vonë kanë dyshuar se kufijtë kadastral nuk përputhen me gjendjen në teren dhe sipas tyre, palët e interesuara, respektivisht të paditurit, e kishin shfrytëzuar mungesën e pronarit dhe në mënyrë të paligjshme kishin uzurpuar pronën e tij duke zhvendosur kufirin, respektivisht megjen, dhe kanë hapur rrugë të re [rruga kontestuese/servituti kontestues] për kalim nëpër pronën e tyre të paluajtshme.
19. Më 3 qershor 2013, I.S., i padituri i parë, në përgjigje në padi kishte theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruesve të kërkesës për uzurpim të pronës së paluajtshme ngase ai e ka blerë ngastrën e tij kadastrale, fqinjë me ngastrën e parashtruesve të kërkesës, në vitin 1973 dhe që nga ai vit është në posedim të saj. Ai theksoi se ngastrën e kishte blerë nga D.O. dhe nga e njëjta pronare i kishin blerë tokat edhe fqinjët e tjerë, respektivisht palët e tjera të interesuara. Qysh në atë kohë, sipas I.S., me shitësen D.O. ishin pajtuar që të gjithë pronarët e ngastrave të cilat i kishte shitur ajo do ta zgjerojnë rrugën në të cilën kishin dalje – meqë ajo ishte e ngushtë – dhe të njëjtën rrugë tashmë janë duke e shfrytëzuar që nga viti 1973. Secili prej pronarëve, sipas I.S., i kishte lëshuar nga 3 metra prej ngastrave të tyre përkatëse për ta bërë rrugën e kalueshme dhe për ta shfrytëzuar bashkërisht si rrugë të përbashkët – e të cilën ata rregullisht e shfrytëzojnë.
20. Më 16 korrik 2013, Gjykata Themelore mbajti shqyrtimi e parë gjyqësor për të trajtuar padinë e parashtruesve të kërkesës. Në këtë seancë gjyqësore, parashtruesit e kërkesës ngelën pas kërkesëpadisë së tyre fillestare. Palët e

interesuar kundërshtuan kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës duke theksuar, në thelb, se ata i kanë blerë pronat e tyre shumë më herët dhe se nuk kanë uzurpuar asnjë pjesë të pronës së parashtruesve të kërkesës. Në fund të seancës gjyqësore, Gjykata Themelore përmes një Aktvendimi procedural miratoi propozimin e parashtruesve të kërkesës për të bërë shqimin e vendit së bashku me ekspertin gjeodet dhe për të identifikuar saktësisht pronën e paluajtshme të parashtruesve të kërkesës. Eksperti gjeodet, Sh.K. u caktua në po atë seancë dhe seanca e radhës shqyrtuese u caktua për datën 4 shtator 2013.

21. Më 4 shtator 2013, Gjykata Themelore mbajti shqyrtimin e dytë gjyqësor për të trajtuar padinë e parashtruesve të kërkesës. Sipas procesverbalit, rezulton që Gjykata e ka dëgjuar ekspertizën e ekspertit gjeodet, sipas të cilit: *“Ngastra kontestuese e cila evidentohet me nr. 5382/4 ZK Pejë në sipërfaqe prej 500 m2 [prona e paluajtshme në fjalë] [...] e cila në evidencën kadastrale evidentohet në emër të Kadri Muriqit dhe Zenun Muriqit [parashtruesve të kërkesës], kufizohet me këto ngastra kadastrale: në anën veriore me ngastrën kadastrale nr. 5385/7 e cila evidentohet në emër të Sh.Sh.; në anën lindore kufizohet me ngastrën kadastrale nr. 5382/32 e cila evidentohet me emër të M.N., e cila ngastër njëherit i ndanë ngastrat e palëve ndërgjyqëse. Në anën jugore ngastra kontestuese kufizohet me ngastrën kadastrale nr. 5382/5 në pronësi të M.P., në anën perendimore ngastra kontestuese kufizohet me ngastrën kadastrale nr. 5382/30, me pronësi të Xh.U., në anën veriore të ngastrës kontestuese në vend të ngjarjes shtrihet rruga e kubëzuar e cila sipas evidencës kadastrale kjo rrugë përgjatë tërë shtrirjes së saj shtrihet në prona private dhe nuk është e evidentuar në regjistrat kadastral si njësi e veçantë.”* Më pas, në procesverbalin e Gjykatës Themelore thuhet se: *“I autorizuari i paditësve [parashtruesve të kërkesës] pa pyetje dhe vërejtje.”* Ndërkaq, në pyetje të palës së interesuar I.S. se në aeroinqizimin e bërë a ekziston rruga kontestuese, eksperti gjeodet u përgjigj se *“bazuar në aerofotografimin e vitit 2004 dhe 2009 rruga ekzistuese paraqitet në të dyja rastet.”* Në fund, Gjykata e urdhëroi ekspertin gjeodet që ta dorëzojë ekspertizën e tij me shkrim në afat prej shtatë (7) ditësh. Eksperti gjeodet e kishte dorëzuar ekspertizën e tij dhe e njëjta është pjesë e dosjes origjinale të rastit.
22. Më 30 shtator 2013, siç u paralajmërua dhe më lart, parashtruesit e kërkesës, përmes avokatit të tyre të ri, e precizuan dhe zgjeruan padinë e tyre fillestare. Ata theksuan se në padinë fillestare nuk ishte cekur saktësisht baza e kërkesëpadisë e as vlera e kontestit dhe rrjedhimisht tanimë po e precizojnë bazën e tyre juridike si *“mohim të servitutit dhe dorëzim të patundshmërisë”* me vlerë të kontestit 5,000.00 euro. Ata po ashtu theksuan se tashmë po e zgjerojnë padinë e tyre edhe ndaj një të padituri të ri, Sh.Sh., i cili tash e tutje duhet të figurojë si i padituri i pestë. Më specifikisht, përmes precizimit të kërkesëpadisë së tyre, parashtruesit e kërkesës kërkuan që Gjykata Themelore të nxjerrë Aktgjykim, ashtu që: (i) të vërtetohet se i padituri I.S. nuk e ka të drejtën e servitutit të kalimit me këmbë, qerre tërheqëse apo automjet tjetër në rrugën kontestuese; (ii) të detyrohet I.S. që parashtruesve të kërkesës t’ua dorëzojë në posedim faktik pjesën lindore të ngastrës kadastrale nr. 5382/4 në sipërfaqe prej 20m2; (iii) të detyrohen Gj.H. dhe A.D. që parashtruesve të kërkesës t’ua dorëzojnë në posedim faktik pjesën jugore të ngastrës kadastrale

nr. 5382/4; (iii) të detyrohen F.L.L. dhe Sh.Sh. që parashtruesve të kërkesës t'ua dorëzojnë në posedim faktik pjesën veriore të ngastrës kadastrale nr. 5382/4; dhe (iv) të detyrohen pesë të paditurit që t'i bartin shpenzimet e procedurës gjyqësore.

23. Pretendimi kryesor i padisë së parashtruesve të kërkesës ishte që të paditurit I.S., D.S., H.S., dhe B.S., të gjithë të familjes S., nuk kanë të drejtë kalimi nëpër rrugën që shtrihet në pronën e tyre të paluajtshme. Pretendim kryesor ishte po ashtu fakti se i padituri I.S. mban në posedim të tij një pjesë të pronës së paluajtshme të parashtruesve të kërkesës në sipërfaqe prej 20m²; i padituri Gj.H. mban në posedim pjesën prej 48 m²; i padituri A.D. sipërfaqen prej 11m² dhe Sh.Sh. sipërfaqen prej 14 m².
24. Si kundërpërgjigje në padinë e parashtruesve të kërkesës, palët e paditura, respektivisht palët e interesuara, në mes tjerash, kishin theksuar se rrugën në fjalë e kanë në shfrytëzim të pandërprerë dhe të papenguar që nga viti 1973 dhe se kjo rrugë është formuar nga pronarja e atëhershme e ngastrave kadastrale, D.O., në marrëveshje me secilin pronar të ngastrave fqinjësore dhe kjo rrugë ekziston edhe sot.
25. Më 28 tetor 2013, parashtruesit e kërkesës e zgjeruan kërkesëpadinë e tyre edhe ndaj H.D.
26. Më 9 dhjetor 2013, pas dështimit të disa seancave shqyrtuese për shkak të mosprezencës së palëve, Gjykata Themelore mbajti shqyrtimi e tretë publik për të trajtuar padinë e parashtruesve të kërkesës. Në këtë shqyrtim publik, parashtruesit e kërkesës deklaruan tërheqjen e padisë së tyre ndaj Sh.Sh. dhe H.D., të cilën kërkesë e miratoi Gjykata Themelore. Përgjatë seancës, parashtruesit e kërkesës theksuan se ata mbesin pranë pjesës tjetër të padisë së tyre; ndërkaq, I.S., i padituri i parë, deklaroi se në vitin 1972 ngastra kontestuese ka qenë livadh dhe 5 persona i kanë blerë ngastrat e tyre dhe janë pajtuar që t'i lëshojnë nga 3 metra për të formuar rrugën kontestuese. Që nga ai vit, sipas tij, nuk ka pasur asnjë problem por që problemet kanë lindur nga momentin kur parashtruesit e kërkesës e kanë blerë pronën e paluajtshme dhe kanë ndërtuar shtëpinë e tyre. Sipas I.S., rruga është e shtruar me "kocka" [kubëza] që 7 vite dhe tani parashtruesit e kërkesës *"po mundohen që ta ndalin rrugën."* Në seancë, I.S. i propozoi Gjykatës që të ftohet fqinji i tyre X. si dëshmitar. Me propozimin e tij për dëgjimin e këtij dëshmitari u pajtuan edhe parashtruesit e kërkesës dhe Gjykata vendosi që i njëjti të ftohet si dëshmitar në seancën e radhës më 23 janar 2014. Për sa i përket propozimit të parashtruesve të kërkesës që të dilet në vend shqim të bashku me ekspertin gjeodet, Gjykata Themelore theksoi se për këtë do të merret vendim në seancën gjyqësore të radhës.
27. Më 18 shkurt 2014, pas dështimit të seancës së përcaktuar për datën 23 janar 2014, Gjykata Themelore mbajti shqyrtimin e katërt gjyqësor për të trajtuar padinë e parashtruesve të kërkesës. Në këtë seancë ishin prezent: avokati i parashtruesve të kërkesës; i autorizuari i I.S., i padituri i dytë Gj.H. dhe i padituri i katërt F.L.L., si dhe tre dëshmitarë të ftuar nga Gjykata, X. Y., dhe Z.

28. Në këtë seancë, Gjykata Themelore, pasi që ua lexoi të drejtat e tyre të parapara me nenet 347.2 dhe 343 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK), i dëgjoi të tre dëshmitarët e lartpërmendur.
29. Dëshmitari i parë, X., deklaroi se: *“diku në vitin 1972 ato pllace janë blerë nga pronarja D.O., [...] dhe jam në dijeni se ajo e ka lëshuar rrugën për me kaluar nëpër ato place për me mujtë me i shitë dhe placet tjera deri tek I.S. Gjithashtu deklaroi se në atë kohë ekspertin kadastral e ka prurë pronarja D. Dhe i ka matë placet një nga një [...]. Që të gjithë kanë pas obligim me e lëshuar rrugën deri në shtëpinë e I.S. dhe I.S.me i ra qasaj rrugës. I.S. është i pari i cili ka filluar me e ndërtuar shtëpinë dhe me hy me kamiona me traktora për me e bajtë materialin e shtëpisë.”* Në pyetjen e Gjykatës Themelore se a është bërë ajo marrëveshje me shkrim apo gojarisht, dëshmitari X. u përgjigj se *“marrëveshja është bërë me shkrim që të gjithë e kemi lëshuar në sipërfaqe në mënyrë të barabartë dhe rruga është 4 metra, ndërsa në gjatësi duhet të jetë rreth 80 metra deri të shtëpia e I.S.”* Në pyetjen e vetme të avokatit të parashtruesve të kërkesës se a e keni evidentuar si rrugë publike në evidencat kadastrale, dëshmitari X. u përgjigj se *“rruga evidentohet në pronën private.”*
30. Dëshmitari i dytë, Y. deklaroi se: *“i pari i cili e ka blerë pronën dhe është vendosë është I.S, pastaj jam unë. Në vitin 1974 kemi filluar ndërtimin e shtëpisë, ndërsa jemi vendosur në atë në vitin 1991 [...]. Jemi marrë vesh kur i kemi ble pllacet për me e lëshuar rrugën secili nga një pjesë nga pjesa e vet e tokës dhe rruga ka qenë e paraparë prej 3 metrave gjerësi dhe që 40 vjet kjo rrugë shfrytëzohet nga ne dhe nga I.S. Para 4 viteve rruga është shtruar me kubëza nga Komuna, dhe kemi qitë kanalën për ujësjellës dhe rrymë dhe të gjithë kemi kontribuar me përqindje me përjashtim të I.S. të cilin e kemi liruar për shkak të gjendjes ekonomike. Paditësi [parashtruesit e kërkesës] me rastin e blerjes e ka blerë të gatshme me rrugë, ujë, rrymë e tani pretendon që ta mbylli këtë rrugë.”* Në pyetje të avokatit të parashtruesve të kërkesës se a i kujtohet se me rastin e ndërtimit të shtëpisë nëpër cilën rrugë ke kaluar, dëshmitari Y. deklaroi se: *“kur ka filluar ndërtimin e shtëpisë I.S. është qelë rruga prej 3 metrave dhe nëpër atë rrugë është bajtë materiali për ndërtimin e shtëpisë.”* Në pyetjen tjetër të avokatit të parashtruesve të kërkesës dëshmitari Y. deklaroi se: *“rruga që kemi lëshuar është në pronë private mendoj se është ashtu [...] Jam i sigurtë se marrëveshja është bërë me shkrim por si pasojë e luftës ajo është asgjësuar.”* Në pyetjen e Gjykatës Themelore se a kanë pasur probleme me atë rrugë, dëshmitari Y. u përgjigj se *“asnjë herë nuk kemi pas problem rreth shfrytëzimit të kësaj rruge e as i padituri I.S. Problemi ka filluar pasi që janë vendosur paditësit [parashtruesit e kërkesës] aty sepse sikur të kishte pas mundësi me ndalë [ish pronari i paluajtshmërisë] i cili ka qenë pronar i tokës por nuk e ka ndalë.”*
31. Dëshmitari i tretë, Z. deklaroi se: *“prej se unë e mbaj në mend dhe qysh më ka treguar baba prej ditës kur e kemi ble pllacin në marrëveshje të shitësit të asaj kohe një pjesë me u lëshua për rrugë dhe një ndër të parët që kanë filluar me e ndërtuar shtëpinë e ka ndërtuar I.S. i cili ka filluar bartjen e materialit për ndërtimin e shtëpisë e ka bartë nëpër atë rrugë. Ne shtëpinë e kemi blerë në vitin 1973 dhe në vitin 1973-74 është ndërtuar edhe shtëpia jonë dhe pas luftës*

kemi kërkuar nga Komuna për me na e shtru atë rrugë me kubëza dhe e kemi rregulluar ujësjellësin dhe rrymën.”

32. Tutje, në të njëjtën seancë, Gjykata Themelore konfirmoi në procesverbal se pa asnjë vërejtje, avokati i parashtruesve të kërkesës, e nënshkroi procesverbalin. Gjykata Themelore, më pas miratoi edhe kërkesën e parashtruesve të kërkesës që të dilet në vend-shiqim së bashku me ekspertin gjeodet Sh.K.
33. Më 17 mars 2014, Gjykata Themelore mbajti shqyrtimi e pestë gjyqësor për të trajtuar padinë e parashtruesve të kërkesës me ç’rast u vazhdua me nxjerrjen e provave të ekspertizës së gjeodetit. Ky i fundit, deklaroi se: *“Pas zbulimit të rrtjetës gjeodezike kemi filluar procedim natyre, me ç’rast në anën lindore dhe perëndimore është bërë tregimi i megjës kadastrale ndërsa në anën jugore dhe veriore është bërë rivlerësimi i murit në të dy anët gjeografike të lartcekura me ç’rast Gjykatën do ta njoftojmë me shkrim rreth pjesës që mbajnë palët kundërpropozuese [palët e paditura] nga ngastra e palës paditëse [parashtruesve të kërkesës].”* Në seancë, Gjykata Themelore e obligoi ekspertin gjeodet që ta paraqes ekspertizën nga vend-shiqimi me shkrim në afat prej 7 (shtatë) ditësh. I gjithë procesverbali u nënshkrua pa asnjë vërejtje nga palët.
34. Brenda afatit të përcaktuar, pasi që kishte dalë në teren me gjyqtaren e rastit, eksperti gjeodet Sh.K., dorëzoi ekspertizën e tij me shkrim. Objekt i ekspertizës ishte matja e detajuar apo rilevimi i pronës së paluajtshme në fjalë. Në ekspertizë gjyqësore theksohen të gjitha pjesët me të cilat kufizohet prona e paluajtshme e parashtruesve të kërkesës si dhe pronarët/poseduesit aktual të atyre ngastrave fqinjë. Sipas ekspertit gjeodet, në terren është bërë piketimi i megjës kadastrale për parcelën kontestuese dhe janë treguar 4 pika detaje bazuar në shënimet kadastrale me të cilat disponon Departamenti i Gjeodezisë i Komunës së Pejës nga skica e matjes e vitit 1973. Në ekspertizë thuhet se, pas procesit të tregimit të këtyre pikave me urdhër të Gjykatës Themelore është bërë *“inqizimi detaj (rilevimi) i gjendjes faktike në teren, ku pas llogaritjeve konstatojmë këtë gjendje:*
- *I padituri, Gj.H. mban në shfrytëzim nga parcela e palës paditëse (5382-4) sipërfaqen prej: 48m² [...]*
 - *I padituri, A.D. mban në shfrytëzim nga parcela e palës paditëse (5382-4) sipërfaqen prej: 11m² [...];*
 - *I padituri, Sh.S. mban në shfrytëzim nga parcela e palës paditëse (5382-4) sipërfaqen prej: 14m² [...];*
 - *Rruga e kubëzuar në teren kalon nepër ngastrën e palës paditëse në sipërfaqe prej: 76m². [...] Gjatësia e rrugës që kalon nepër ngastrën e palës paditëse është 22.41m nga pika: r2 deri në r1. [...]”*
35. Si sqarim plotësues, në ekspertizën e tij gjyqësore, eksperti gjeodet theksoi: *“Parcela e paditësit [parashtruesve të kërkesës] në pjesën tekstuale-Certifikatë të Pronës ka sipërfaqe prej: 500m², ndërsa në pjesën grafike – nga pikat e kufijve të jashtëm kadastral (pikat 1, 53, 4, 3, 477, dhe 2) ka sipërfaqe prej: 560 m². Pra, dallimi është 60m². Ky dallim ka lindur dhe është trashëguar nga ndarja dhe formimi i parcelës së palës paditëse në skicën e matjes të vitit*

1973. Pala paditëse [parashtruesit e kërkesës] aktualisht në terren ka sipërfaqe të shfrytëzueshme prej: 411m². Kjo sipërfaqe është pa pjesët të cilat i mbajnë në shfrytëzim palët e paditura fqinjë dhe pa pjesën e rrugës [kontestuese].”

36. Gjkata Themelore u kishte dërguar parashtruesve të kërkesës një kopje të ekspertizës së lartcekur gjyqësore të përgatitur nga eksperti gjeodet.
37. Më 2 prill 2014, parashtruesit e kërkesës parashtruan vërejtjet e tyre ndaj ekspertizës së lartcekur të Sh.K. duke theksuar se: “*eksperti nuk ka shënuar fizikisht pikat kadastrale 1, 2, 3, 4*” dhe se, sipas tyre, nuk ishte precizuar sipërfaqja e ngastrës të cilën Gj.H. e kishte zënë me shtëpi; nuk ishte precizuar sipërfaqja e uzurpuar e Y.S. në anën lindore; nuk është matë saktë sipërfaqja e uzurpuar nga poseduesi F.LL., respektivisht pronari Sh.S. Përmes kësaj shkrese, parashtruesit e kërkesës po ashtu e tërhoqën padinë e parashtruar ndaj F.LL. ngase ai nuk ishte pronar i njërës nga ngastrat fqinjësore, por ishte Sh.S., të cilin kërkuan ta ricilësojnë sërish si palë të paditur.
38. Më 10 prill 2014, Gjkata Themelore mbajti shqyrtimin e gjashtë gjyqësor për të trajtuar padinë e parashtruesve të kërkesës. Në këtë seancë, parashtruesit e kërkesës kërkuan që të nxjerrët super-ekspertizë gjyqësore. Me Aktvendim procedural në po të njëjtën seancë, Gjkata Themelore e refuzoi kërkesën e parashtruesve për super-ekspertizë të gjeodezisë. Po ashtu u vendos që të paditurit Sh.Sh. t’i caktohet një avokat i përkohshëm meqë ishte jashtë shtetit.
39. Më 15 prill 2014, Gjkata Themelore mbajti shqyrtimin e shtatë gjyqësor për të trajtuar padinë e parashtruesve të kërkesës. Në këtë seancë, u vendos që për tërheqjen e padisë ndaj F.LL., Gjkata Themelore do të sjellë vendim si dhe, për zgjerimin e padisë ndaj Sh.Sh., ajo do të vendosë pasi që i njëjti të njoftohet mbi padinë e ushtruar ndaj tij.
40. Më 13 maj 2014, Gjkata Themelore mbajti shqyrtimin e tetë gjyqësor për të trajtuar padinë e parashtruesve të kërkesës. Në këtë seancë, parashtruesit e kërkesës kërkuan që në seancën e radhës të ftohet eksperti gjeodet për të sqaruar vërejtjet e parashtruesve të kërkesës të paraqitura me shkrim më 1 prill 2014 ndaj ekspertizës gjyqësore. Gjkata Themelore e miratoi kërkesën e parashtruesve të kërkesës dhe vendosi të ftojë ekspertin gjeodet Sh.K. për seancën e radhës. Në fund, po ashtu u konsiderua si e tërhequr padia e parashtruesve të kërkesës ndaj F.LL dhe u vendos që Sh.Sh. do të ftohet për tu deklaruar rreth zgjerimit të padisë edhe ndaj tij.
41. Më 2 korrik 2014, parashtruesit e kërkesës, përmes një avokati tjetër të ri, e specifikuan tutje dhe e zgjeruan padinë e tyre edhe ndaj tre djemve të të paditurit të parë I.S., respektivisht ndaj H.S., D.S. dhe B.S.
42. Më 3 korrik 2014, Gjkata Themelore mbajti shqyrtimin e nëntë gjyqësor për të trajtuar padinë e parashtruesve të kërkesës. Në këtë seancë, në mes tjerash, u kërkuua shtyrja e saj për shkak se pala e paditur Sh.Sh. pritej të vijë personalisht në Kosovë nga Gjermania. Kjo kërkesë u miratua dhe seanca u shty për 27 gusht 2014.

43. Më 27 gusht 2014, Gjykata Themelore mbajti shqyrtimin e dhjetë gjyqësor për të trajtuar padinë e parashtruesve të kërkesës. Në këtë seancë, parashtruesit e kërkesës kërkuar që në seancën e radhës të ftohen që të dy ekspertët gjeodet, F.H. dhe Sh.K. duke qenë se, sipas tyre, ekspertizat e tyre janë në kundërshtim njëra me tjetrën dhe për vërtetimin e gjendjes faktike është e nevojshme që të dilet përsëri në vend-shiqim së bashku me ekspertët. Gjykata Themelore e miratoi këtë kërkesë të parashtruesve të kërkesës dhe vendosi që për seancën e radhës të ftohen të dy ekspertët e propozuar. [Sqarim: Eksperti gjeodet F.H. kishte paraqitur ekspertizën e tij më 16 dhjetor 2011].
44. Më 30 shtator 2014, Gjykata Themelore mbajti shqyrtimin e njëmbëdhjetë gjyqësor për të trajtuar padinë e parashtruesve të kërkesës. Në këtë seancë u miratua kërkesa e parashtruesve të kërkesës që të dy ekspertët gjeodet, Sh.K dhe F.H., të sqarojnë ekspertizat e tyre të dhëna me shkrim dhe të japin përgjigje për katër pikat apo koordinatat e kërkuara nga parashtruesit e kërkesës. Në këtë seancë, parashtruesit e kërkesës kërkuar nga Gjykata Themelore që të obligohen ekspertët gjeodet që t'i bëjnë shënimet dhe përcaktimin e 4 pikave koordinatë të parcelës kontestuese si dhe *"të përcaktohet saktë dhe në mënyrë grafike dhe numerike pjesa e ngastrës së uzurpuar."* Pas kësaj, Gjykata me Aktvendim procedural vendosi që të miratojë propozimin e parashtruesve të kërkesës dhe të obligojë të dy ekspertët gjeodet që të japin sqarimet e tyre përkatëse lidhur me 4 pikat koordinatë të kërkuara nga parashtruesit e kërkesës. Gjatë seancës, ekspertët u deklaruan dhe dhanë sqarimet e tyre përkatëse dhe të gjitha ato sqarime dhe deklarata janë reflektuar në procesverbalin e seancës gjyqësore i cili është pranuar dhe nënshkruar edhe nga avokati i parashtruesve të kërkesës.
45. Më 12 qershor 2015, parashtruesit e kërkesës, në lidhje me padinë e tyre, paraqitën edhe kërkesë për caktimin e masës së sigurisë përmes së cilës kërkuar *"ndalim të kalimit, në çfarëdo forme, nëpër pronën-ngastrën e paditësve"* [parashtruesve të kërkesës]. Sipas tyre, kjo masë duhet të merret *"urgjentisht nga Gjykata për të evituar dëmet e pariparueshme që mund tu ndodhin atyre duke marrë parasysh rrethanat në të cilat ndodhen."*
46. Më 20 korrik 2015, Gjykata Themelore mbajti shqyrtimin e dymbëdhjetë gjyqësor për të trajtuar padinë e parashtruesve të kërkesës. Në këtë seancë parashtruesit e kërkesës propozuan që të caktohet një grup tjetër ekspertësh, për shkak se në ekspertizën e parë është konstatuar se është uzurpuar sipërfaqja prej 27m nga Sh.Sh., ndërkaq nga ekspertiza e dytë është konstatuar se kemi të bëjmë me sipërfaqe prej 14m² – me çka rezulton në një diferencë të madhe në sipërfaqen kontestuese. Përmes Aktvendimin në po të njëjtën seancë, Gjykata Themelore vendosi që ta refuzojë propozimin e parashtruesve të kërkesës nxjerrjen e super-ekspertizës.
47. Më 14 shtator 2015, Gjykata Themelore mbajti shqyrtimin e trembëdhjetë gjyqësor për të trajtuar padinë e parashtruesve të kërkesës. Në këtë seancë, Gjykata i obligoi parashtruesit e kërkesës që të rregullojnë kërkesën e tyre për masë të sigurisë në mënyrë që e njëjta të shqyrtohet; në të kundërtën, ajo do të konsiderohet si e tërhequr.

48. Më 17 shtator 2015 dhe më 12 tetor 2015, respektivisht, parashtruesit e kërkesës e rregulluan kërkesën e tyre për masë të sigurisë dhe e precizuan atë tutje.
49. Më 18 maj 2016, Gjykata Themelore mbajti shqyrtimin e katërmbëdhjetë gjyqësor për të trajtuar padinë e parashtruesve të kërkesës. Seanca e kësaj date ishte seanca e shqyrtimit kryesor. Në këtë seancë, parashtruesit e kërkesës deklaruan se e drejta e tyre për posedim të pronës po mohohet dhe po favorizohen palët e paditura. Tutje, Gjykata Themelore vendosi që të nxjerrën provat për këtë çështje dhe si të tilla i lexoi dhe i morri parasysh provat vijuese: (i) Kontrata e shitblerjes së patundshmërisë e lidhur në mes të parashtruesve të kërkesës dhe M.I.M. dhe vërtetimi i së njëjtës në Gjykatën Komunale në Pejë; (ii) Certifikata e Pronësisë që konfirmon pronësinë e parashtruesve të kërkesës; (iii) Kopjet e planit të 23 korrikut 2010; (iv) Vendimi i KPCC; (v) Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Pejë nr. 17/11 i 16 dhjetorit 2011 përmes së cilit, në procedurë jo-kontestimore, u caktua megja në bazë të shënimeve zyrtare kadastrale të vitit 1973 me njërin nga fqinjët A.U. të parashtruesve të kërkesës, ndërkaq për mospajtimet e tjera me fqinjët e tjerë parashtruesit e kërkesës u udhëzuan të parashtrojnë padi në procedurë kontestimore për të zgjidhur kontestin; (vi) ekspertiza e ekspertit gjeodet F.H. e 16 dhjetorit 2011; (vii) ekspertiza e ekspertit gjeodet Sh.K. e 16 korrikut 2013, kopja e planit, skica e matjes dhe certifikatat e pronësisë, skica e vitit 1973; (viii) ortofotot e 9 tetorit 2010; dhe (ix) të gjitha shkresat e tjera të dosjes C.nr.896/12. Pasi që parashtruesit e kërkesës nuk kishin vërejtje, Gjykata Themelore ia dha mundësinë që të japin fjalën përfundimtare. Për këtë të fundit, parashtruesit e kërkesës përfundimisht theksuan: *“Kam sjellë të gjitha provat që vërtetojnë se jam pronar i pronës kontestuese lirimi i së cilës kërkohet nga ana e të paditurve, me anë të ortofotove vërtetohet se të paditurit në periudha të ndryshme i kanë shty kufijtë si dhe në vend të rrugës së mëparshme kanë hapur një rrugë të re nëpër pronën tani të paditësve, këtë e kanë bërë pa asnjë të drejtë ligjore pasi që ata nuk janë pronar të pronës të cilën e posedojnë dhe nga e cila hyn në pronën e paditësve, të paditurit nuk kanë sjellë asnjë provë që do të vërtetonte pretendimet e tyre për ta poseduar pronën e paditësve [...] andaj kërkoj nga gjykata që ta aprovojë padinë e paditësve.”*

Procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta për vendosjen mbi padinë e parashtruesve të kërkesës për “mohim të servitutit dhe dorëzim të patundshmërisë” si dhe për kërkesë e parashtruesve për masë të sigurisë

Vendimmarrja në Gjykatën Themelore

50. Më 18 maj 2016, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C.nr.896/12], e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës në tërësi si të pabazuar duke e theksuar pabazueshmërinë në fjalë përmes pesë pikave të theksuara në dispozitiv të atij Aktgjykimi.
51. Në atë aspekt, Gjykata Themelore vendosi që të refuzojë si të pabazuar: (1) kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës për të vërtetuar se palët e paditura

[babai I.S. dhe të bijtë e tij H.S., D.S. dhe B.S., si dhe fqinjët e tjerë A.D., Gj.H. dhe Sh.Sh.] nuk e kanë të drejtën e kalimit në këmbë, me qerre tërheqëse apo automjet tjetër në pjesën veriore të ngastrës kadastrale në fjalë; (2) kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës që të detyrohet I.S. që t'ia dorëzojë në posedim të lirë dhe faktik pjesën lindore të ngastrës kadastrale në fjalë; (3) kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës që të detyrohen Gj.H. dhe A.D. që t'ua dorëzojnë në posedim të lirë dhe faktik pjesën jugore të ngastrës kadastrale në fjalë; (4) propozimin e parashtruesve të kërkesës për lëshimin e masës së përkohshme të sigurisë dhe (5) kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës që tu paguhen shpenzimet e procedurës kontestimore.

52. Gjykata Themelore sqaroi se nuk është kontestues fakti që parashtruesit e kërkesës e kanë blerë pronën e paluajtshme në fjalë me sipërfaqe prej 500 m², dhe se që të dy parashtruesit e kërkesës janë bashkëpronar me nga 1/2 të pjesës ideale të kësaj patundshmërie. Tutje, nuk është kontestues fakti as që atyre iu është dorëzuar në posedim dhe shfrytëzim vetëm sipërfaqja prej 411 m², e as që nga prona totale e parashtruesve të kërkesës 76 m² janë rrugë, 14 m² janë në posedim të Sh.Sh., 48 m² në posedim të Gj.H., dhe 11 m² në posedim të A.D. Kontestuese, sipas Gjykatës Themelore, përgjatë shqyrtimit kryesor *“ishte çështja e parashtruar nga parashtruesit e kërkesës, sipas të cilëve, të paditurit pa bazë ligjore dhe në mënyrë të paligjshme mbajnë pronën e paditësve [parashtruesve të kërkesës] dhe atë: të paditurit [në fjalë] nuk kanë të drejtë servituti të kalimit me këmbë, qerre, tërheqje apo automjet nëpër patundshmërinë e paditësve [parashtruesve të kërkesës] pasi që rruga në sipërfaqe prej 72 m² shtrihet në pronën e paditësve e cila rrugë nuk ka qenë e themeluar dhe regjistruar në regjistrat në librat e tokës në kuptim të nenit 51, 52, 53 dhe 54 të LMTHJP [Ligji për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore]. Gjithashtu të paditurit I.S., sipërfaqe prej 20 m², Gj.H., sipërfaqes prej 48 m², si dhe i padituri A.D., 11 m², në mënyrë të paligjshëm mbajnë pronën e paditësve lirimi i së cilës kërkohet me padi.”*
53. Në këtë aspekt, Gjykata Themelore theksoi se për vërtetimin e kësaj gjendje faktike ajo kishte dëgjuar deklaratat e dëshmitarëve X., Y., dhe Z. [shih deklaratat e tyre në paragrafët 28-31 të këtij Aktvendimi, ku, në mes tjerash, ishte theksuar se parashtruesit e kërkesës *“kur e kanë blerë tokën e kanë blerë me rrugë[n kontestuese]”*. Përveç dëshmitarëve, Gjykata Themelore në Aktgjykimin e saj theksoi se nga ekspertiza e ekspertit gjeodet, Sh.K., vërtetohet se nga prona e paluajtshme e parashtruesve të kërkesës me sipërfaqe prej 500 m², i padituri Gj.H. mban në shfrytëzim 48 m² nga prona e paluajtshme e parashtruesve; i padituri A.D. mban në shfrytëzim 11 m² nga prona e paluajtshme e parashtruesve; i padituri Sh.Sh. mban në shfrytëzim 14 m² nga prona e paluajtshme e parashtruesve. Gjykata Themelore thekson se eksperti gjeodet ka konstatuar se *“rruga e kubëzuar kalon nëpër ngastrën e paditësve [parashtruesve të kërkesës] më sipërfaqe prej 76 m²”* dhe se ai ka sqaruar se parashtruesit e kërkesës *“në bazë të certifikatës së pronës kanë sipërfaqen prej 500 m² ndërsa në pjesën grafike – pikat e kufijve të jashtëm kadastrale (pikat 1, 53, 4, 3, 477 dhe 2) ka sipërfaqe prej 560 m², e që dallimi është 60 m². Ky dallim ka lindur dhe ishte trashëguar me ndarjen dhe formimin e parcelës së palës paditëse [parashtruesve të kërkesës] me skicën e matjes së vitit 1973.”*

54. Në nëntitullin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore për sa i përket “Arsyetimit juridik dhe ligjor”, Gjykata Themelore theksoi se ajo nuk mund të pajtohet me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se rruga e cila është objekt kontesti nuk është regjistruar në regjistrat kadastral, se nuk figuron si rrugë por se është pronë private e parashtruesve të kërkesës dhe se kërkesëpadia e tyre gjen mbështetje në nenet 51, 52, 53 dhe 54.2 të LMTHJP, sepse, sipas Gjykatës Themelore: *“kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar, në kuptim të nenit 58 të LMTHJP, i cili parasheh se servituti pushon vetëm në qoftë se pronari i pronës shërbyese kundërshton ushtrimin e tij, kurse pronari i pronës sunduese për tre vjet rresht nuk e ushtron këtë të drejtë të vet, apo nëse pronari i pronës shërbyese mund të kërkojë që të pushojë e drejta e servitutit kur ai bëhet i panevojshëm për shfrytëzimin e punës sunduese ose kur nuk ekzistojnë më arsyet për të cilat është vendosë.”* Tutje, u theksua se *“ka rezultuar e provuar me fakte dhe prova se rruga, objekt kontesti, mohimi i së cilës kërkohet nga paditësit, ka ekzistuar nga viti 1973-74, fakte të vërtetuara me dëgjimin e dëshmitarëve X., Y. dhe Z., të cilëve gjykata edhe u fal besimin sepse dëshmia e tyre përputhet edhe me prova të tjera në lëndë me skicën e matjes nr. 13 dt. 21.08.1973, e lëshuar nga Komuna e Pejës, kur edhe figuron ndarja e parcelave dhe atë: 1) I.S., parcela nr. 5382/29; 2) M.M. parcelën nr. 5382/4, tani e paditësve; parcelës nr. 5382/30, B.U., etj, dhe me marrëveshjen e pronarëve të patundshmërisë edhe ishte formuar rruga për kalim për pronarët e parcelave të lartcekura dhe rruga objekt kontesti ishte shfrytëzuar pa ndërprerje nga pronarët e mëparshëm dhe shfrytëzohet edhe tani nga pronarët aktual, për çka edhe padia e paditësve mbi këtë bazë u deshtë të refuzohet.”*
55. Në fund, Gjykata Themelore theksoi se ajo pajtohet me parashtruesit e kërkesës se e drejta e pronësisë është e garantuar me Kushtetutë, norma ndërkombëtare dhe ligj, po se sipas saj, ata nuk kishin arritur që të dëshmojnë bazueshmërinë e kërkesëpadisë së tyre *“gjegjësisht nuk arritën të argumentojnë faktin se të paditurit kishin uzurpuar në mënyrë të paligjshme pasurinë e tyre.”* Për sa i përket kërkesës së tyre për caktim të masës së sigurisë, Gjykata Themelore theksoi se e njëjta duhet të refuzohet si e pabazuar ngase parashtruesit e kërkesës nuk kanë arritur të argumentojnë rrezikun që do të mund t’ju shkaktohej.
56. Përfundimisht, Gjykata Themelore e refuzoi në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës si të pabazuar.

Vendimmarrja në Gjykatën e Apelit

57. Më 22 qershor 2016, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me kërkesën që të ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe të miratohet kërkesëpadia e tyre si e bazuar. Më konkretisht, ata ishin ankuar se gjendja faktike nuk ishte vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe se nuk ishte miratuar kërkesa e tyre për super-ekspertizë.

58. Më 25 janar 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.2743/2016] e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtresve të kërkesës dhe e konfirmoi në tërësi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore.
59. Për sa i përket pretendimeve të parashtresve të kërkesës për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit arsyetoi se të tillat pretendime *“janë të pabazuara dhe të pa qëndrueshme, me arsyetim se, me asnjë provë bindëse e të argumentuar, nuk kanë arritur të argumentojnë ndonjë gjendje tjetër faktike, nga ajo të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, në mënyrë që gjykata e shkallës së dytë, të marrë ndonjë vendim ndryshe, nga ai të cilin e ka marrë gjykata e shkallës së parë.”* Tutje lidhur me këtë pretendim, Gjykata e Apelit theksoi se: *“gjykata e shkallës së parë, bazuar në provat ekspertizën përkatëse të gjeodezisë, deklaratat e dëshmitarëve si dhe faktet jokontestuese, drejtë ka vërtetuar faktin se paditësit, pa të drejtë kërkojnë mohimin e të drejtës së servitutit për të paditurit, të cilët sipas vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, rrugën e tillë ku paditësit pretendojnë mohimin e servitutit, të paditurit e shfrytëzojnë që nga viti 1973-1974 dhe lidhur me të, nuk ka pasur asnjëherë ndonjë pengesë.”*
60. Gjykata e Apelit tutje arsyetoi se parashtresit e kërkesës *“nuk mund të kërkojnë një të drejtë, të cilën nuk e ka pasë as vet pronari i mëparshëm, përkatësisht shitësi i rastit konkret, prej të cilit paditësit e kanë blerë paluajtshmërinë në 2010.”* Sipas Gjykatës së Apelit po ashtu nuk qëndron pretendimi ankimor se paditësit ia kanë uzurpuar rrugën e cila është objekt i kontestit sepse *“në vitin 2010 ata e kanë blerë pronën e tyre së bashku me pjesën e rrugës e cila e përbën edhe ngastrën si tërësi, fakt ky i cili rezultoi edhe nga ekspertiza e gjeodezisë.”* Për rrugën e cila ekziston e për të cilën për vite të tëra nuk ka pasur pengesa nga askush dhe nuk plotësohen kushtet ligjore për shuarje të servitutit përkatësisht mohim të tij, atëherë, sipas Gjykatës së Apelit, Gjykata Themelore *“me të drejtë ka vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësve.”*
61. Për sa i përket pretendimeve të parashtresve të kërkesës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, përkatësisht për çështjen e ekspertëve dhe superekspertizës së kërkuara nga parashtresit e kërkesës, Gjykata e Apelit arsyetoi se të tillat pretendime gjithashtu nuk janë të bazuara. Në këtë aspekt, Gjykata e Apelit arsyetoi se: *“[...] nuk qëndron pretendimi ankimor i paditësve për superekspertizë sepse gjatë procedurës provuese kur janë lexuar dhe administruar provat, e ndër to edhe ekspertizat në procesverbalin e 18.05.2016, nuk ka pasë asnjë vërejtje nga paditësit, por është shënuar paditësi pa vërejtje. Kjo diferencë në metra e cila thuhet nga paditësit, paraqitet në mendimin e ekspertëve, mirëpo sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, kjo diferencë nuk regjistrohët, por vetëm konstatohët, sepse servituti në rastin konkret nuk po krijohët, ngase ai veç ka ekzistuar si i tillë.”*
62. Tutje, Gjykata e Apelit po ashtu theksoi se: *“gjatë seancave nga pala paditëse nuk ka pasur propozim që të ftohen ekspertët që kanë kryer ekspertizat dhe në situatën e tillë nuk mund të thuhët se ka shkelje të nenit 362.1 të LPK-së.”*

Ndërkaq, gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur arsye të veproj sipas nenit 144.1 dhe 147.1 të LPK-së, ashtu që nga Gjykata e Apelit edhe pretendimi i paditësve, duke ju referuar dispozitave në fjalë u refuzua si i pabazë. Është fakt se paditësit kanë kërkuar që t'iu mundësohet super ekspertizë gjyqësore, por një gjë e tillë është refuzuar nga gjykata e shkallës së parë, për faktin se e njejta është e panevojshme, ashtu siç konsideron edhe tani Gjykata e Apelit, sepse me rëndësi është fakti se, gjendja faktike është konstatuar drejtë dhe ligjshëm dhe se nuk ekziston uzurpim siç pa të drejtë pretendohet nga paditësit. [...] Pra nuk mund të thuhet se ka uzurpim të pronës siç ka konstatuar Komisioni i kërkesave pronësore të Kosovës, sepse fjala uzurpim i referohet pronësisë ku është menduar për pronën si tërësi, e jo për servitutit e rastit konkret në veçanti, për të cilin në situatën ekzistuese nuk mund të thuhet se ka uzurpim. Atëherë pjesa e paluajtshmërisë që shfrytëzohet si rrugë edhe nga të paditurit e rastit konkret, është fakt se figuron si pronë e paditësve, por në Kosovë ka plot situata të tilla, kur edhe pse është rrugë (servitut), ende prona figuron në emër të pronarit të ngastrës nëpër të cilën kalon ajo rrugë, e nuk është regjistruar si rrugë.”

63. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesve të kërkesës rreth asaj se Gjykata Themelore gabimisht e ka shtjelluar çështjen nga prizmi i “shuarjes së servitutit” në vend se atë ta shtjellojë nga prizmi i “mohimit të servitutit”, Gjykata e Apelit, duke theksuar dispozitat ligjore [nenet 51, 54 dhe 58 të LMTHJP; nenin 260 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Sendore; dhe literaturën juridike] kishte arsyetuar se: *“kjo nuk qëndron sepse mohimi i servitutit nuk mund të qëndroj sepse i njëjti në mënyrën e përhershme me vite të tëra ekziston si i tillë dhe është i krijuar, ndërsa nuk ka arsye ligjore për mohimin e tij siç pa të drejtë pretendohet nga paditësit. [...] në rastin konkret, me vet faktin se paditësit kërkojnë mohimin e servitutit të të paditurve, atëherë del se bëhet fjalë për shuarjen e një servituti i cili ka ekzistuar si i tillë në kohë të gjatë ndërsa nuk plotësohen kushtet nga dispozita e nenit [54] të sipër cekur.”*
64. Gjykata e Apelit konkludoi arsyetimin e saj duke theksuar se pa marrë parasysh që ndonjë pjesë e pronës së paluajtshme të palëve të paditura ende ekziston në emër të dikujt tjetër mirëpo ata janë posedues të asaj prone për nevojat e së cilës rruga, përkatësisht servituti i rastit konkret akoma është i nevojshëm dhe i domosdoshëm. Sipas nenit 54 të LMTHJP, sqaroi Gjykata e Apelit, *“Servituti real fitohet me anë të parashkrimit fitues kur pronari i pronës sunduese ka realizuar faktikisht servitutit gjatë kohës prej 20 vjetësh, kurse pronari i pronës shërbyese këtë nuk e ka kundërshtuar.”* Andaj, bazuar në gjendje faktike dhe në këto dispozita ligjore, Gjykata e Apelit vlerësoi po ashtu se kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës *“nuk ka bazë ligjore dhe si e tillë me të drejtë është refuzuar nga Gjykata e shkallës së parë.”*
65. Përfundimisht, Gjykata e Apelit e refuzoi në tërësi ankesën e parashtruesve të kërkesës dhe e konfirmoi në tërësi vendimmarrjen e Gjykatës Themelore.

Vendimmarrja në Gjykatën Supreme

66. Më 14 mars 2018, parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme mbi bazën e dy pretendimeve kryesore, përkatësisht (i) shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe (ii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
67. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës pretenduan para Gjykatës Supreme se: nuk është shqyrtuar prova e tyre përmes së cilës ata kishin kërkuar që si dëshmitarë të dëgjohen edhe ish-pronarët e tokave; nuk janë shikuar orto-fotot dhe aero-fotografimi i vitit 2004 ku shihet se I.S. për hyrje në shtëpinë e tij ka shfrytëzuar rrugë tjetër nga ana lindore; gjykata e shkallës së parë nuk ua ka miratuar atyre kërkesën për superekspertizë; Gjykata e Apelit *“nuk ka dhënë fare asnjë arsyetim për shkeljet e bëra nga gjykata e shkallës së parë”* e as nuk ka dhënë arsyetim përkitazi me zgjerimin e padisë edhe ndaj Sh.Sh. Sipas parashtruesve të kërkesës ata nuk kanë qenë në njohuri se prona e paluajtshme që ata e kanë blerë nga ish-pronari ka qenë *“e ngarkuar me kërkesa reale nga ndokush e as nga të paditurit.”* Rruga të cilën të paditurit e shfrytëzojnë, sipas parashtruesve të kërkesës në kërkesën e tyre për revizion, *“nuk e kanë fituar me asnjë bazë ligjore por në baza të kundërligjshme, me uzurpim, pasi që të paditurit nuk e vërtetojnë me asnjërin prej 3 bazave të fitimit të servitutit që parashihet me nenin 51 të LMTHJP.”*
68. Më 4 korrik 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.157/2018] e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesve për revizion. Kësisoj, Gjykata Supreme konfirmoi në tërësi vendimmarrjen e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit për refuzim të kërkesëpadisë së parashtruesve të kërkesës si të pabazuar.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

69. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që Gjykata Supreme u ka shkelur atyre të drejtat e garantuara për: (i) gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; (ii) mbrojtje të pronës sipas nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe (iii) të drejtat për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe zgjidhje efektive sipas nenit 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.
70. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se ata kishin paraqitur para gjykatave të rregullta prova dhe fakte se ish pronari i pronës kontestuese nga i cili ata e kishin blerë pronën e kishte fituar të drejtën e plotë mbi atë pronë përmes Vendimit të KPCC dhe se kjo e fundit kishte urdhëruar fqinjët që e kishin uzurpuar atë që ta lirojnë. Vendimi i këtij Komisioni, pohojnë parashtruesit, kishte marrë formën e prerë.
71. Më tutje, parashtruesit e kërkesës theksojnë se ish-pronari ua kishte shitur dhe dorëzuar atyre pronën në fjalë *“pa asnjë ngarkesë apo servitut, dhe se fqinjët nuk e kishin liruar pronën në tërësi si dhe fqinjët nga ana lindore e ngastrës së tyre kishin hapur një rrugë me sipërfaqe 70 metra katror në anën veriore të tyre.”* Ata në këtë aspekt pohojnë se për të mbështetur këtë fakt, parashtruesit e kërkesës i kishin propozuar gjykatave të rregullta fakte, siç ishte vendimi i

formës së prerë i Komisionit KPCC/D/A/19/2008 i 20 qershorit 2008 si dhe ortofotot nga aero-fotografimet e vitit 2004 dhe 2009 nga të cilat, sipas tyre, shihet qartë se ndërmjet viteve 2004 dhe 2009, fqinjët lindor me mbiemrin S. *“kishin mbyllur rrugën e gjerë atëhershme nëpër posedimin e tyre dhe kishin hapur rrugë të re nëpër ngastrën tani të parashtruesve.”*

72. Po ashtu, parashtruesit e kërkesës theksojnë se gjykatave të rregullta u kishin propozuar që në cilësinë e dëshmitarëve të dëgjoheshin ish-pronarët [I.M., M.P. dhe M.N.] dhe të vërtetohej se fqinjët lindor të familjes S. nuk ishin pronar të ngastrës që posedonin – e të cilën e pretendonin si ngastër dominuese – dhe se të drejtën e tyre për servitut nuk e kishin regjistruar në Regjistrin e të Drejtave të Paluajtshmërive. Prandaj, sipas parashtruesve të kërkesës, *“në bazë të normave ligjore në fuqi nuk kishin të drejtën e fitimit të drejtës së servitutit nëpër ngastrën e tyre.”*
73. Për sa i përket Aktgjykimit [C.nr.896/12] të 18 majit 2016 të Gjykatës Themelore, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ai ka qenë i parregullt dhe nuk ka qenë i paanshëm. Gjyqtarja e rastit, sipas pretendimit, *“ka ushtruar autoritetin e saj në mënyrë arbitrare pasi që gjatë procedurës nuk i ka shqyrtuar pretendimet dhe provat mbështetëse të këtyre pretendimeve të palës paditëse – parashtruese, ndërsa nga pala e paditur nuk ka kërkuar prova për të mbështetur ligjshmërinë e të drejtës së posedimit të ngastrës së parashtruesve.”* Ata theksojnë se Aktgjykimi [C. nr. 896/12] i 18 majit 2016 i Gjykatës Themelore *“nuk është i drejtë sepse nuk është i arsyetuar as në nivel procedural as në nivel material”* dhe përmes të njëjtit *“nuk janë shqyrtuar faktet dhe provat që kanë parashtruar parashtruesit.”*
74. Ata theksojnë se kërkesa e tyre për super-ekspertizë është refuzuar në mënyrë arbitrare nga Gjykata Themelore; nuk janë thirrur për të dëshmuar dëshmitarët e propozuar; nuk janë pyetur për provën vendimtare që kanë propozuar parashtruesit e kërkesës lidhur me ortofotot e viteve 2004 dhe 2009; nuk janë përkrahur normat juridike në bazë të të cilave është refuzuar mbrojtja ligjore e kërkuar e as norma ligjore në bazë të së cilës kjo mbrojtje u është dhënë të të paditurve. Ky Aktgjykim, sipas tyre, nuk pasqyron vlerësim të paanshëm të fakteve dhe provave të parashtruara nga palët. Me këtë Aktgjykim veçse është përmbushur vullneti i të paditurve dhe i dëshmitarëve të propozuar nga ata dhe është krijuar një gjendje e re faktike e ndryshme nga ajo reale. Gjendje e tillë e re faktike, sipas parashtruesve të kërkesës, është krijuar duke u mbështetur vetëm në deklaratat e dëshmitarëve-fqinjëve të të paditurve të cilët kanë deklaruar se për hapjen e rrugës kontestuese ka pasur një marrëveshje të shkruar, ndërmjet fqinjëve, në vitet e 70-ta, por që parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se nga deklaratat e këtyre dëshmitarëve vërehet qartë se *“ka pasur një marrëveshje paraprake ndërmjet të paditurve dhe fqinjëve të tyre dëshmitar, për të dëshmuar se kjo rrugë nuk është hapur pas luftës por ka qenë e hapur në vitet e 70-ta.”*
75. Për sa i përket Aktgjykimit [Ac.nr.2743/2016] të 25 janarit 2018 të Gjykatës së Apelit, parashtruesit e kërkesës theksojnë se i njëjti po ashtu nuk është në pajtueshmëri me nenet e Kushtetutës dhe KEDNJ-së të cilët ata pretendojnë se janë shkelur. Sipas tyre, shihet qartë se Aktgjykimi në fjalë nuk ka shqyrtuar

faktet dhe provat e parashtruara në ankesën e parashtruesve të kërkesës dhe se i njëjti kryesisht bazohet “*në gjendjen faktike joreale të krijuar me Aktgjykimin e atakuar dhe përshkruan pohimet nga Aktgjykimi i atakuar [i Gjykatës Themelore]*”. Ky Aktgjykim, sipas tyre, nuk ka dhënë arsyetimin e kërkuar në ankesë, se përse në këtë çështje nuk kishin gjetur zbatim nenet 124, 259 dhe 295.p3 të LPDS-së, konform Rregullores së UNMIK-ut 2002/22.

76. Për sa i përket Aktgjykimit [Rev.nr.157/2018] të 4 korrikut 2018 të Gjykatës Supreme, parashtruesit e kërkesës theksojnë se as ai nuk është në pajtueshmëri me nenet e Kushtetutës dhe KEDNJ-së të cilët ata pretendojnë se janë shkelur. Sipas tyre, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të saj nuk ka dhënë asnjë arsyetim që do t'i bindte parashtruesit e kërkesës se janë marrë në shqyrtim thëniet e tyre në revizion. Ata konsiderojnë se në Aktgjykimin e kontestuar “*nuk gjenden fare përgjigje as shqyrtim të fakteve dhe provave të parashtruara në revizion*”, por thjeshtë, sipas tyre, përsëriten thëniet nga Aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore.
77. Përgjithësisht për të gjitha vendimet e marra nga gjykatat e rregullta, respektivisht nga ajo Themelore, e Apelit dhe Supreme, parashtruesit e kërkesës pohojnë se ato do duhej të jepnin arsye bindëse se në bazë të cilës normë juridike e kanë fituar të drejtën e posedimit mbi ngastrën kontestuese të paditurit, respektivisht palët e interesuara. Kjo kryesisht, sipas parashtruesve të kërkesës, duke pasur parasysh faktin se këtë të drejtë ata e kishin humbur me vendimin e formës së prerë të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/19/2008 të 20 qershorit 2018 në të cilin vendim përfundimisht është përcaktuar “*qartë se kush ka të drejtën e pronës dhe të posedimit mbi 1/1 të kësaj prone dhe urdhëronte të gjithë të tjerët (përfshirë edhe të paditurit [palët e interesuara]) që të heqin dorë nga posedimi i kësaj prone.*”
78. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës theksojnë se vendimet e gjykatave të rregullta, gjatë shqyrtimit të çështjes së tyre nuk kanë zbatuar normat e njëjta si në rastet e ngjashme të trajtuara nga kjo Gjykatë dhe në këtë aspekt parashtruesit e kërkesës i referohen rastit KI67/16 lidhur me parimin *res judicata*; rastet e bashkuara KI58/09 dhe të tjerët lidhur me pritjen legjitime; dhe rastit KI89/12 lidhur me krijimin e servitutit.
79. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata më sa vijon:
- (i) të shpallet kërkesa e pranueshme;
 - (ii) të shpallet si i pavlefshëm Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme;
 - (iii) të detyrohet Gjykata Supreme që të nxjerrë një Aktgjykim tjetër me të cilin do të njihet e drejta e parashtruesve që të posedojnë në mënyrë të qetë dhe pa pengesa me tërë pasurinë e tyre, gjegjësisht me ngastrën kadastrale nr. 5382/4.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
5. Prona intelektuale mbrohet me ligj

Ligji për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (LMTHJP), i 30 janarit 1980, i aplikueshëm në rrethanat e rastit KI194/18

Kreu III E DREJTA E SERVITUTIT

Neni 49

Servitut real është e drejta e pronarit të një pasurie të paluajtshme (prona sunduese) që për nevojat e kësaj pasurie të paluajtshme të kryejë veprime të caktuara në pasurinë e paluajtshme të pronarit tjetër (prona shërbyese) ose të kërkojë nga pronari i pronës shërbyese që të përmbahet nga kryerja e veprimeve të caktuara që përndryshe do të kishte drejtë ti kryente në pasurinë e vet të paluajtshme. Servituti real mund të vendoset edhe për kohë të caktuar ose për stinë të caktuar të vitit.

Në qoftë se prona sunduese ose prona shërbyese është mjet shoqëror në personin juridik shoqëror, punëtorët dhe punonjësit e tjerë në këtë person juridik shoqëror kanë të drejtat, respektivisht obligimet që i kanë bartësit e të drejtave, respektivisht të obligimeve që rrjedhin nga servitutet reale, po që se me ligj ose me kontratë nuk është caktuar ndryshe.

Neni 50

Servituti real ushtrohet ashtu që sa më pak të ngarkohet prona shërbyese. Në qoftë se gjatë ushtrimit të servitutit real nevojitet shfrytëzimi i ndonjë instalimi ose ndërmarrja e ndonjë veprimi, shpenzimet e mirëmbajtjes së këtij instalimi dhe të ndërmarrjes së këtij veprimi i heq pronari i pronës sunduese.

Në qoftë se instalimi ose veprimi shërben edhe për interesat e pronarit të pronës shërbyese, shpenzimet e mirëmbajtjes së këtij instalimi dhe shpenzimet e ndërmarrjes së këtij veprimi i heqin, në përpjestim me dobinë që kanë, pronari i pronës sunduese dhe pronari i pronës shërbyese.

Neni 51

Servituti real vendoset me veprimin juridik, vendimin e organit shtetëror dhe me anë të parashkrimit fitues.

Neni 52

Në bazë të veprimit juridik servituti real fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj.

Neni 53

Me vendimin e gjykatës mbi pjesëtimin e sendit ose me vendimin e organit tjetër shtetëror servituti real vendoset kur pronari i pronës sunduese në tërësi ose pjesërisht nuk mund të shfrytëzojë këto pronë pa shfrytëzimin përkatës të pronës shërbyese si dhe në raste të tjera të caktuara me ligj.

Servituti nga paragrafi i 1 këtij neni fitohet ditën që merr formën e prerë vendimi po që se me ligj nuk është caktuar ndryshe.

Me kërkesën e pronarit të tokën shërbyese, organi kompetent shtetëror përcakton edhe kompensimin përkatës, të cilin pronari i pronës sunduese ka për detyrë t'ia paguajë pronarit të pronës shërbyese.

Neni 54

Servituti real fitohet me anë të parashkrimit fitues kur pronari i pronës sunduese ka realizuar faktikisht servitutin gjatë kohës prej 20 vjetësh, kurse pronari i pronës shërbyese këtë nuk e ka kundërshtuar.

Servituti real nuk mund të fitohet me anë të parashkrimit fitues poqese është ushtruar me keqpërdorimin e besimit të pronarit ose të mbajtësit të pronës shërbyese, me forcë, me mashtrim, apo nëse servituti është ceduar

deri në revokim.

Neni 55

Servituti real mbi pasurinë e paluajtshme që është mjet shoqëror në personin juridik-shoqëror nuk mund të fitohet me anë të parashkrimit fitues.

Neni 56

Pronari i pronës sunduese mund të kërkojë që ndaj pronarit të pronës shërbyese të përcaktohet ekzistimi i servitutit real.

Në padinë nga paragrafi 1 i këtij neni aplikohen me analogji dispozitat e nenit 37 paragrafi 2 të këtij ligji.

Neni 57

Në qoftë se pronari i pronës sunduese pa bazë ndalohej ose pengohet në ushtrimin e servitutit real, ai mund të kërkojë me padi që ky ndalim ose pengim pushojë.

Neni 58

Servituti real pushon në qoftë se pronari i pronës shërbyese kundërshton ushtrimin e tij, kurse pronari i pronës sunduese tre vjet rrjesht nuk e kaushtruar të drejtën e vet.

Pronari i pronës shërbyese mund të kërkojë që të pushojë e drejta e servitutit real kur ai bëhet i panevojshëm për shfrytëzimin e punës sunduese ose kur nuk ekziston më arsyeja për të cilën ai është vendosur.

Servituti real pushon po që se nuk ushtrohet gjatë kohës së nevojshme për fitimin e tij me anë të parashkrimit fitues, kur i njëjti person bëhet pronar i pronës shërbyese dhe i pronës sunduese ose me shkatërrimin e pronës sunduese, respektivisht të pronës shërbyese.

Ligji nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore

Neni 260 Shuarja e servitutit sendor

1. Për shuarjen e servitutit sendor janë të nevojshme deklarata e pronarit të paluajtshmërisë dominuese për heqjen dorë nga servituti sendor dhe regjistrimi në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëritë.

2. Pronari i paluajtshmërisë së ngarkuar mund të kërkojë shlyerjen e servitutit sendor, nëse servituti sendor nuk është më i nevojshëm për shfrytëzimin e paluajtshmërisë dominuese ose nëse në mënyrë substanciale kanë ndryshuar rrethanat. Shlyerja e servitutit duhet të regjistrohet në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri.

Pranueshmëria e kërkesës

80. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe të përcaktuara me Rregulloren e punës.

81. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

82. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë siç janë të përcaktuara me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

83. Në kërkesën e tyre para kësaj Gjykate, në thelb, parashtruesit e kërkesës kanë ngritur tri pretendime. Pretendimi i parë ka të bëjë me (i) shkelje të së drejtës së tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Pretendimi i dytë ka të bëjë me (ii) shkelje të së drejtës për mbrojtje të pronës të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Dhe, së fundmi, pretendimi i tretë ka të bëjë me (iii) shkelje të së drejtës për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe zgjidhje efektive sipas nenit 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.

84. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuar të cilët kontestojnë akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr.157/2018] e 4 korrikut 2018 të Gjykatës Supreme, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Lidhur me të

drejtat e tyre të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së [pretendimi i parë] dhe nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së [pretendimi i dytë], Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës i kanë sqaruar pretendimet e tyre në pajtim me kushtet që kërkojnë nga neni 48 i Ligjit. Ata gjithashtu, e kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit. Rrjedhimisht, më tutje, Gjykata do të shqyrtojë kriteret e tjera të pranueshmërisë për sa i takon pretendimit të parë, për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dhe pretendimit të dytë të parashtruesve të kërkesës, për shkelje të së drejtës për mbrojtje të pronës. Lidhur me këto dy pretendime, tutje dhe bashkërisht, Gjykata do të shqyrtojë gjithashtu nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e tjera të pranueshmërisë të përcaktuara me rregullin 39 (2) të Rregullores, që përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe mbështetet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

85. Gjykata thekson se bazuar në paragrafin (2), të rregullit 39 të Rregullores së punës, ajo mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesit e kërkesës nuk dëshmojnë dhe nuk mbështesin në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tyre për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton pretendimet përkatëse të parashtruesve të kërkesës të përmbledhura në paragrafët 68-78 të këtij Aktvendimi.
86. Gjykata po ashtu rikujton thelbin e çështjes i cili është më sa vijon: Kërkesa KI194/18 buron si pasojë e një kontesti fqinjësor rreth të drejtës së servitutit, respektivisht kalimit në një rrugë në një fshat në Komunën e Pejës. Parashtruesit e kërkesës, dy vëllezër, e kishin blerë një pronë të paluajtshme, dhe të njëjtën kishin arritur ta regjistronin si pronë të tyre të përbashkët në regjistrin kadastral të Komunës së Pejës, ashtu që secili prej tyre ishte pronar i 1/2 e të gjithë pronës së paluajtshme. Fakti që parashtruesit e kërkesës ishin pronar legjitim të pronës në fjalë nuk ishte asnjëherë kontestuese në procedurat para gjykatave të rregullta. Kontestuese, përgjatë gjithë procesit gjyqësor ishte fakti se a kanë të drejtë servituti fqinjët në rrugën e cila kalonte nëpër dhe përkrah pronës së tyre të përbashkët apo jo. Si rrjedhojë, ata kishin iniciuar padi fillimisht ndaj pronarëve/poseduesve të pronave fqinje, I.S., Gj.H., A.D., dhe F.L.L. dhe më pas, me precizim dhe zgjerim final të padisë, edhe ndaj Sh.Sh. dhe të bijve të I.S.-së, respektivisht, H.S., D.S., B.S. Ndaj F.L.L.-së, një fqinji tjetër, ata e kishin tërhequr padinë e tyre pasi që kishin kuptuar se ai nuk ishte as pronar e as posedues i ngastrës fqinje. Si përfundim, palë të paditura në këtë rast dhe rrjedhimisht palë të interesuara në rastin KI194/18 janë gjithsej shtatë, respektivisht prindi I.S. dhe 3 bijtë e tij H.S., D.S., dhe B.S., si dhe Gj.H., A.D., dhe Sh.Sh. Pas zhvillimit të procedurave gjyqësore për të trajtuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës të paraqitura në padinë e tyre “për mohim të servitutit dhe dorëzim të patundshmërisë”; pas dëgjimit të përgjigjeve në padi të paraqitura nga palët e interesuara; pas ekspertizave të gjeodezisë dhe dëgjimit të dëshmitareve fqinjë dhe, pas zhvillimit të gjithsej 14 seancave shqyrtuese, Gjykata Themelore kishte

vendosur që ta refuzojë kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës në tërësi duke vendosur, në thelb që, tashmë është krijuar servituti për kalim në këtë rrugë qysh në vitet 1973-74 dhe që nga ajo kohë të gjithë fqinjët e kanë shfrytëzuar rrugën pa asnjë pengesë dhe se për të njëjtën nuk është ankuar ish-pronari asnjëherë. Më pas, Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme e kishin konfirmuar vendimmarrjen e Gjykatës Themelore duke vendosur përfundimisht për refuzimin e padisë së parashtruesve të kërkesës. Para Gjykatës Kushtetuese po kontestohet vendimmarrja e Gjykatës Supreme, në lidhje me dy vendimet e tjera të instancave më të ulëta gjyqësore të cilat e kishin refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës si të pabazuar.

Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ për sa i përket arsyetimit të vendimeve gjyqësore; superekspertizës dhe ftesës së dëshmitarëve të propozuar nga parashtruesit e kërkesës

87. Parashtruesit e kërkesës, në thelb, ankohen se në rastin e tyre, gjykatat e rregullta u kanë shkelur atyre të drejtën e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së: (i) duke mos arsyetuar mjaftueshëm vendimet gjyqësore; (ii) duke mos miratuar kërkesën e tyre për superekspertizë dhe (iii) duke mos ftuar dëshmitarët e propozuar nga ata.
88. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton petitumin final të parashtruesve të kërkesës ku ata kërkojnë që të anulohet Aktgjykimi [Rev.nr.157/2018] i 4 korrikut 2018 i Gjykatës Supreme dhe të detyrohet kjo e fundit që të nxjerrë Aktgjykim të ri me të cilin njihet e drejta e parashtruesve të kërkesës që të posedojnë në mënyrë të qetë dhe pa pengesa pronën e tyre.
89. Në dritë të këtyre pretendimeve, Gjykata fillimisht rikujton se Gjykata Apelit ua kishte refuzuar ankesën e tyre të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe më pas Gjykata Supreme ua kishte refuzuar kërkesën për revizion të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Sipas kësaj Gjykate, të dyja gjykatat e rregullta, respektivisht Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit, por edhe ajo Themelore gjatë vendimmarrjes fillestare për kërkesëpadi, i kanë përmbushur detyrimet e tyre kushtetuese dhe ligjore për të ofruar një arsyetim të mjaftueshëm ligjor ashtu siç kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ si dhe në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe praktikën gjyqësore të vet kësaj Gjykate.
90. Në përfundimin e lartcekur, Gjykata ka arritur pasi që ka shqyrtuar padinë dhe të gjitha ankesat e parashtruara nga parashtruesit e kërkesës në raport me vendimet gjyqësore të nxjerra nga gjykatat e rregullta.
91. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit ishte përgjegjës në të gjitha pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, përfshirë dhe pretendimin konkret për refuzim të kërkesës së tyre për superekspertizë. Për më tepër në këtë aspekt, shih në detaje arsyetimin e Gjykatës së Apelit të

reflektuar gjerësisht dhe konkretisht në paragrafët 56-64 të këtij Aktvendimi – ku është dhënë përgjigje në raport me pretendimet ankimore të parashtruesve të kërkesës.

92. Për sa i takon pretendimeve të parashtruesve të kërkesës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, përkatësisht për çështjen e ekspertëve dhe superekspertizës së kërkuar nga parashtruesit e kërkesës, Gjykata e Apelit kishte theksuar se: *“[...] nuk qëndron pretendimi ankimor i paditësve për superekspertizë sepse gjatë procedurës provuese kur janë lexuar dhe administruar provat, e ndër to edhe ekspertizat në procesverbalin e 18.05.2016, nuk ka pasë asnjë vërejtje nga paditësit, por është shënuar paditësi pa vërejtje. Kjo diferencë në metra e cila thuhet nga paditësit, paraqitet në mendimin e ekspertëve, mirëpo sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, kjo diferencë nuk regjistrohet, por vetëm konstatohet, sepse servituti në rastin konkret nuk po krijohet, ngase ai veç ka ekzistuar si i tillë.”*
93. Tutje, Gjykata e Apelit poashtu ka theksuar se *“është fakt që [parashtruesit e kërkesës] kanë kërkuar që t’u mundësohet super ekspertizë gjyqësore, por një gjë e tillë është refuzuar nga gjykata e shkallës së parë, për faktin se e njëjta është e panevojshme, ashtu siç konsideron edhe tani Gjykata e Apelit, sepse me rëndësi është fakti se, gjendja faktike është konstatuar drejtë dhe ligjshëm dhe se nuk ekziston uzurpim siç pa të drejtë pretendohet nga paditësit.”* Përfundimisht, pasi që kishte shqyrtuar të gjitha pretendimet thelbësore, Gjykata e Apelit e kishte refuzuar ankesën e parashtruesve të kërkesës si të pabazuar.
94. Më tutje, dhe duke qenë se vendimi i fundit i kontestuar i gjykatave të rregullta është ai i Gjykatës Supreme, Gjykata në vijim do të shpjegojë se përse konsideron se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të të drejtave të tyre nga ana e Gjykatës Supreme, nuk janë mjaftueshëm të mbështetura dhe si të tilla nuk qëndrojnë dhe janë qartazi të pabazuara.
95. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht rikujton se para Gjykatës Supreme, parashtruesit e kërkesës, kishin pretenduar se: *“nuk është shqyrtuar prova e tyre përmes së cilës ata kishin kërkuar që si dëshmitarë të dëgjohen edhe ish-pronarët e tokave; nuk janë shikuar orto-fotot dhe aero-fotografimi i vitit 2004 ku shihet se I.S. për hyrje në shtëpinë e tij ka shfrytëzuar rrugë tjetër nga ana lindore; gjykata e shkallës së parë nuk ua ka miratuar atyre kërkesën për superekspertizë; Gjykata e Apelit “nuk ka dhënë fare asnjë arsyetim për shkeljet e bëra nga gjykata e shkallës së parë” [...]; sipas parashtruesve të kërkesës ata nuk kanë qenë në njohuri se prona e paluajtshme që ata e kanë blerë nga ish-pronari ka qenë “e ngarkuar me kërkesa reale nga ndokush e as nga të paditurit.” Rruga të cilën të paditurit e shfrytëzojnë, sipas parashtruesve të kërkesës në kërkesën e tyre për revizion, “nuk e kanë fituar me asnjë bazë ligjore por në baza të kundërligjshme, me uzurpim, pasi që të paditurit nuk e vërtetojnë me asnjërin prej 3 bazave të fitimit të servitutit që parashihet me nenin 51 të LMTHJP.”*

96. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme lidhur me këto pretendime të parashtruesve të kërkesës – të paraqitura në revizion, të cilat ata pretendojnë se nuk u janë adresuar.
97. Lidhur me pretendimet për vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, Gjykata Supreme kishte theksuar se: *“gjykatat e instancës më të ulët drejtë dhe në mënyrë të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike që ka të bëjë me faktet vendimtare për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike, në një gjendje të tillë faktike, sipas vlerësimit të kësaj gjykate në mënyrë të drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale [...]. Sipas gjendjes së vërtetuar faktike del se rruga e cila është objekti i kontestit shfrytëzohet pa ndërprerë që nga viti 1973 dhe e njëjta është lënë për kalim sipas marrëveshjes së pronarëve të parcelave nëpër të cilat kalon kjo rrugë dhe se në një pjesë kalon edhe nëpër ngastrën e paditësve në prej 76m2. Sipas dispozitës së nenit 54 paragrafi 1 i LTHMPJ e cila është e aplikueshme në këtë çështje juridike është paraparë "se servituti real fitohet në bazë të parashkrimit fitues kur pronari i pronës sunduese ka realizuar faktikisht servitutin gjatë kohës prej 20 vjetësh, kurse pronari i tokës shërbyese këtë nuk e ka kundërshtuar". Gjykata e shkallës së parë në bazë të dispozitës në fjalë, drejtë ka vlerësuar se të paditurit kanë fituar të drejtën e servitutit në rrugën e cila shtrihet në ngastrën 5382/4 në pronësi të paditësve si pasuri shërbyese, pasi që të paditurit këtë rrugë e shfrytëzojnë më tepër se 20 vite dhe se edhe paditësit kur e kanë blerë ngastrën në fjalë e kanë blerë me rrugë ekzistuese. Sipas nenit 51 LTHMPJ, servituti real vendoset me veprim juridik, vendimin e organit shtetëror dhe me anë të parashkrimit fitues e që në rastin konkret baza e fitimit të servitutit është parashkrimi fitues.”*
98. Lidhur me pretendimet e parashtruesve të kërkesës se Gjykata e Apelit dhe ajo Themelore nuk i kanë arsyetuar vendimet e tyre kur e kanë refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës pa asnjë bazë ligjore, Gjykata Supreme kishte theksuar se: *“Nuk qëndrojnë thëniet e revizionit të paditësve se gjykata e shkallës së dytë kur ka refuzuar ankesën e paditësve nuk është bazuar në asnjë dispozitë ligjore lidhur me pjesët e uzurpuar të ngastrës së paditësve dhe lidhur me refuzimin për dorëzimin e pjesëve të uzurpuara nga të paditurit. Të paditurit të drejtën e servitutit, kalimit në këmbë, qerre tërheqëse apo automjete, nëpër ngastrën e paditësve e kanë fituar me parashkrimin fitues, pasi që të paditurit kanë ushtruar të drejtën e servitutit të kalimit më tepër se 20 vite, ndërsa për këtë nuk kanë kundërshtuar paditësit si pronarë të pasurisë shërbyese dhe se të paditurit nuk kanë fituar të drejtën e servitutit të kalimit me keqpërdorim të besimit të pronarit të pasurisë shërbyese. Prandaj thëniet e revizionit se marrëveshja për të hapur rrugën nuk është e legalizuar, nuk janë më ndikim në këtë çështje juridike pasi të paditurit të drejtën e servitutit të kalimit e kanë fituar me parashkrim fitues e jo me veprim juridik.”*
99. Lidhur me pretendimin e parashtruesve për mos miratim të kërkesës së tyre që të nxjerrët si provë edhe dëgjimi në cilësi të dëshmitarëve edhe të ish-pronarëve të ngastrave kadastrale fqinjësore që tashmë i përkasin parashtruesve të kërkesës dhe palëve të interesuara, Gjykata vëren se qëndron fakti se kërkesa e parashtruesve të kërkesës nuk është miratuar nga gjykatat e

rregullta. Pra, prova e propozuar nga ata për t'i thirrur si dëshmitarë ish-pronarët nuk është miratuar nga gjykatat e rregullta.

100. Në këtë drejtim është shumë e rëndësishme të theksohet se është detyrë parësore e gjykatave të rregullta që të *“bëjnë një ekzaminim të duhur të parashtresave, argumenteve dhe provave të propozuara nga palët në procedurë”* (shih, në këtë drejtim, *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 19 prillit 1994, paragrafi 59). Janë pikërisht gjykatat vendore (ato të rregullta në nivel të Republikës së Kosovës) ato të cilat janë në pozicionin më të mirë për të vlerësuar relevancën e dëshmimeve lidhur me çështjet që ndërlidhen me rastin në fjalë (shih, në mes të autoriteteve të tjera, vendimmarrjen e GJEDNJ-së në rastet: *Vidal kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 22 prillit 1992, paragrafi 32, faqe 32-33, dhe *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 34).
101. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për gjykim të drejtë nuk garanton në mënyrë eksplicite të drejtën për të thirrur dëshmitarë në procedurë civile; dhe, në nivel parimesh, çështja e pranueshmërisë së provave dhe dëshmimeve është çështje e ligjit vendor të shteteve kontraktuese. Roli i GJEDNJ-së në atë drejtim nuk është që të zëvendësojë mënyrën e vlerësimit të fakteve nga ana e gjykatave vendore (shih, *Wierzbicki kundër Polonisë*, Aktgjykim i 18 qershorit 2002, paragrafi 39; *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 27 tetorit 1993).
102. Për rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se propozimi për ftesën e ish-pronarëve si dëshmitarë nuk është konsideruar si provë relevante e cila do të ndihmonte në qartësimin e fakteve rreth çështjes së rastit duke qenë se gjendja faktike ishte vërtetuar nga një mori e madhe e provave, ekspertizave, fotografimeve në teren, vend-shiqimeve, dëgjimit të dëshmitarëve fqinjë, dokumentacionit relevant kadastral etj. Pra, gjykatat e rregullta kanë konsideruar që nuk është e nevojshme që të ftojnë ish-pronarët e ngastrave kadastrale si dëshmitarë ngase kanë qenë të bindura se provat në rast kanë qenë të mjaftueshme për të vërtetuar saktë gjendjen faktike – e cila edhe ishte konfirmuar si e tillë në nivel të tri gjykatave.
103. Tani, në këtë aspekt, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të ndërhyjë në punën e gjykatave të rregullta duke vendosur barrë të panevojshme tek ato – duke pasur parasysh faktin se ato e kanë kryer punën e tyre në përputhje me standardet e kërkuara për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe vendimmarrjen e tyre nuk e kanë bazuar vetëm në një provë po në një mori provash. Në vendimin e tyre se nuk ka nevojë të ftohen ish-pronarët si dëshmitarë, kjo Gjykate nuk sheh ndonjë arbitraritet që potencialisht do të mund të dërgonte në shkelje të të drejtave të parashtresve të kërkesës.
104. Tutje dhe krejt në fund, Gjykata vë në theks faktin që Gjykata Supreme, lidhur me çështjen kryesore të parashtresve të kërkesës, kishte theksuar se: *“Në të vërtetë në rastin konkret kemi të bëjmë me të metat juridike të sendit lidhur me dispozitat e neneve 508-515 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, dispozitat që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga evikcioni. Sipas nenit 508 të LMD, shitësi përgjigjet mbi objektin që shitet ekziston e drejta e tretit, e cila*

përjashton, e zvogëlon apo kufizon të drejtën e blerësit. Sipas nenit 510 par. 1 të njëjtit ligj me rastin e marrjes së objektit të shitblerjes nga blerësi, kontrata zgjidhet sipas ligjit, kurse në paragrafin 3 të nenit në fjalë, blerësi ka të drejtë kompensimin e dëmit të pësuar. Nga kjo del se paditësit kanë të drejtë që nga shitësi i kësaj parcele të kërkojnë kompensimin e dëmit të pësuar për shkak se sendi i shitur ka pasur të meta juridike.”

105. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në refuzimin e një ankese, apo siç është rasti konkret, refuzimi i një kërkesë për revizion, Gjykata Supreme, në parim, thjesht mund të miratojë arsyet për nxjerrjen e vendimit të gjykatës më të ulët, në këtë rast Gjykatës së Apelit (shih rastet e GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; *Helle kundër Finlandës*, kërkesa nr. 20772/92, Aktgjykimi i 19 dhjetorit 1997, Raportet 1997-VIII, paragrafët 59-60).
106. Ngjashëm dhe në po këtë linjë arsyetimi, Gjykata po ashtu rikujton se rastet kur një gjykatë e shkallës së tretë apo e apelit konfirmon vendimet e marra nga gjykatat më të ulëta – obligimi i saj për të arsyetuar vendimmarrjen dallon nga rastet kur një gjykatë ndryshon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta. Në rastin konkret, Gjykata Supreme nuk ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Apelit e as atë të Gjykatës Themelore – me të cilat është refuzuar padia e parashtruesve të kërkesës për mohim të servitutit - por vetëm ka vërtetuar ligjshmërinë e tyre, duke qenë se, sipas Gjykatës Supreme në mënyrë të drejtë ishte vërtetuar gjendja faktike dhe vendimmarrja në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Themelore ishte në përputhje me të drejtën materiale dhe procedurale për sa i përket çështjes së mohimit të servitutit. Pra, Gjykata Supreme ka konfirmuar plotësisht se kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës për t'i urdhëruar fqinjët e tij që ta lirojnë tërësisht rrugën dhe të mos e përdorin të drejtën e tyre të servitutit ishte e pabazë ngase servituti ishte krijuar qysh në kohën kur pronari i parë e kishte pasur në posedim dhe pronësi pronën e paluajtshme në fjalë dhe asnjëherë një gjë e tillë nuk ishte vënë në kundërshtim. Pra, kërkesa e parashtruesve, në thelb, ishte parashkruar.
107. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se, ndonëse Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit mund të mos jenë përgjigjur në secilën pikë të mundshme të ngritur nga parashtruesit e kërkesës në kërkesën e tyre për revizion, respektivisht në ankesë, ato i kanë adresuar argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës për sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike, zbatimit të së drejtës materiale dhe procedurale dhe shkeljeve të mundshme siç ishte pretenduar nga parashtruesit e kërkesës (shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së: *Van de Hurk kundër Holandës*, cituar më lart, paragrafi 61; *Buzescu kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 63; dhe *Pronina kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006, paragrafi 25). Duke vepruar kështu, Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit e kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për të ofruar një vendim të arsyetuar gjyqësor, sipas kërkesave të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ dhe të vet kësaj Gjykate.
108. Andaj, si rezultat, pretendimi i parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ, për çështje të arsyetimit të

vendimeve gjyqësore, superekspertizës dhe dëgjimit të disa dëshmitarëve shtesë është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese. Si i tillë, ky pretendim duhet të refuzohet mbi bazën e rregullit 39 (2) të Rregullores së punës.

Lidhur me pretendimet për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ për sa i përket mbrojtjes së pronës

109. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta i kanë shkelur atyre të drejtën e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së: (i) duke mos ua njohur të drejtën në tërësinë e pronës së tyre, përfshi atë e cila për nga arsyetimet e gjykatave të rregullta është konsideruar si servitut i krijuar në vitet e 70-ta.
110. Parashtruesit e kërkesës në këtë aspekt ankohen se në rastin e tyre, gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtën për mbrojtje të pronës meqenëse ata e kanë blerë pronën e paluajtshme nga ish-pronari i cili të njëjtën, sipas tyre, ua kishte shitur *“pa asnjë ngarkesë apo servitut”* dhe se, pa të drejtë, *“fqinjët [palët e interesuara apo të paditura] nuk e kishin liruar pronën në tërësi”*. Rrjedhimisht, paluajtshmëria kontestuese në fjalë ku edhe kalon rruga që është konsideruar si servitut, sipas parashtruesve të kërkesës, është *“uzurpuar”* në mënyrë të padrejtë nga palët e interesuara.
111. Sipas kësaj Gjykate, të gjitha gjykatat e rregullta e kishin trajtuar, në thelb, të drejtën për mbrojtje të pronës dhe ishin përgjigjur në mënyrë të qartë se servituti në fjalë ishte krijuar qysh në vitet e 70-ta dhe se për rrjedhojë nuk kemi të bëjmë me uzurpim të paluajtshmërisë por me përdorim të pronës bazuar në të drejtën e servitutit të fituar – e i cili nuk ishte kundërshtuar asnjëherë nga ish-pronari i paluajtshmërisë dhe për rrjedhojë kishte ardhur deri tek parashkrimi absolut i kërkesës për mohim të tij. Me fjalë të tjera, gjykatat e rregullta kishin konsideruar që parashtruesit e kërkesës e kishin blerë pronën e tyre me barrë të servitutit dhe fakti që janë ndërruar pronarët nuk e bën servitutin automatikisht të paligjshëm. Përkundrazi, nëse parashtruesit e kërkesës kanë pasur ndonjë kritikë për të metat e sendit, respektivisht paluajtshmërisë që e kanë blerë, ata është dashur të kërkojnë kompensim nga ish-pronari që ua ka shitur atyre paluajtshmërinë kontestuese.
112. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, të cituar më lart, e sipas të cilit: *“1. E drejta e pronës është e garantuar. 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik. 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet. [...]”*.
113. Gjykata vëren se në paragrafin e parë të nenit 46 të Kushtetutës, parashihet, në mënyrë të përgjithshme, se e drejta e pronës është e garantuar me Kushtetutë. Në të dytin paragraf, sanksionohet se shfrytëzimi i pronës nga ana e pronarëve të pronave rregullohet me ligj dhe në pajtim me interesin publik. Në fjalinë e

parë të të tretit paragraf, qartësohet se askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Në fjalinë e dytë të të tretit paragraf, bëhet e ditur që e drejta në pronë nuk është një e drejtë absolute por një e drejtë e kualifikuar e cila, në kushte të caktuara, mund edhe të eksproprijohet.

114. Në rastin e tanishëm, pretendimet e parashtruesve të kërkesës mund të cilësohen si pretendime sipas të cilave ata konsiderojnë se janë privuar “*në mënyrë arbitrare nga prona*”, ngase pjesa e pronës së tyre e cila shërben si servitut dhe shfrytëzohet nga fqinjët është “*uzurpuar*” nga këta të fundit.
115. Në këtë drejtim, Gjykata po ashtu vëren se GJEDNJ, në interpretim të nenit 1 të Protokollit nr. 1, ka konstatuar se e drejta e pronës përbëhet nga tri rregulla të ndryshme. Rregulli i parë, i cili ka natyrë të përgjithshme, formulon parimin e gëzimit paqësor të pasurisë; kjo përcaktohet në fjalinë e parë të paragrafit të parë të nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Rregulli i dytë përfshin privimin nga pasuria dhe ia nënshtrohet të njëjtin kushteve të caktuara; kjo përcaktohet në fjalinë e dytë të të njëjtit paragraf. Rregulli i tretë ua njeh shteteve, ndërmjet të tjerash, të drejtën për të kontrolluar shfrytëzimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, duke zbatuar ato ligje që ato i çmojnë të nevojshme për këtë qëllim; kjo përcaktohet në paragrafin e dytë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 shtatorit 1982, *Sporrong dhe Lonnrot kundër Suedisë*, nr. 7151/75; 7152/75, para. 61).
116. Të tri rregullat nuk janë, megjithatë, “të ndryshme” në kuptimin e të qenët të pandërlidhura. Rregulli i dytë dhe i tretë kanë të bëjnë me raste të veçanta të ndërhyrjes në të drejtën për gëzimin paqësor të pronës dhe, prandaj duhet të interpretohen në dritën e parimit të përgjithshëm të përcaktuar në rregullin e parë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 shkurtit 1986, *James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8793/79, paragrafi 37).
117. Në këtë aspekt, duke vlerësuar kushtetutshmërinë e vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme në frymën e pretendimeve për shkelje kushtetuese dhe fakteve të prezantuara nga parashtruesit e kërkesës dhe ato që Gjykata i ka vënë re nga dosja e plotë, Gjykata konstaton se nuk janë paraqitur argumente të mjaftueshme të cilat do të mund të dëshmonin se në rastin konkret kemi të bëjmë me shkelje të së drejtës në pronë apo privim arbitrar nga prona e as të së drejtës në gëzim paqësor të saj.
118. Lidhur me pretendimet e parashtruesve të kërkesës se ata janë pronar në bazë të Kontratës së shitblerjes me ish-pronarin dhe se prona e tyre ishte uzurpuar nga fqinjët, Gjykata Supreme kishte arsyetuar se: “*Sa i përket pretendimeve të revizionit se paditësit janë pronarë në bazë të kontratës mbi shitblerjen e ngastrës 3852/2 ne sipërfaqe prej 500 m2, se i padituri Gj.H. ka uzurpuar sipërfaqen prej 48 m2, i padituri A.D. sipërfaqen prej 11 m2, ndërsa Sh.Sh. sipërfaqen prej 14 m2, nuk qëndrojnë nga arsyeja se shitësi i cili ka tjetërsuar sipërfaqe më të vogël nga ajo që është e paguar, shitësi ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit për sipërfaqen më të vogël të dorëzuar blerësve. Shitësi, me kontratën mbi shitblerjen të vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Pejë [...], blerësve këtu paditësve ka tjetërsuar sipërfaqen prej 500 m2 ndërsa*

gjendja faktike nuk është përputh me gjendjen faktike. E drejta e pronësisë nuk fitohet vetëm me regjistrimin në kadastër, edhe nga vetë fakti se paditësit dhe shitësi [i paluajtshmërisë]: nuk kanë qenë në posedim të pjesëve kontestuese”. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme po ashtu kishte pranuar se në rastin konkret “kemi të bëjmë me të metat juridike të sendit” dhe “sipas nenit 508 të LMD, shitësi përgjigjet po që se mbi objektin që shitet ekziston e drejta e të tretit, e cila përjashton, e zvogëlon apo kufizon të drejtën e blerësit.” Andaj, sipas Gjykatës Supreme, “paditësit kanë të drejtë që nga shitësi i kësaj parcele të kërkojnë kompensimin e dëmit të pësuar për shkak se sendi i shitur ka pasur të meta juridike.”

119. Në dritën e të gjitha këtyre që u thanë më sipër, Gjykata më tej konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme apo në Gjykatën e Apelit kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tyre të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës materiale apo procedurale. Gjykata rithekson qëndrimin e saj të përgjithshëm se, parimisht, interpretimi i ligjit, material dhe procedural, është detyrë primare e gjykatave të rregullta dhe, si e tillë, është çështje e ligjshmërisë (shih rastin e Gjykatës, KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu, rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjukaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
120. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre se procedurat përkatëse për refuzimin e kërkesëpadisë së tyre për mohim të servitutit në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme është shkelur e drejta e tyre për mbrojtje të pronës (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
121. Siç edhe është e ditur nga praktika gjyqësore e kësaj Gjykate, nuk është detyrë e kësaj të fundit që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin [LMTHJP – në këtë rast konkret] që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu, rastin: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

122. Andaj, si rezultat, pretendimi i parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, për çështje të mbrojtjes së pronës, është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese. Si i tillë, ky pretendim duhet të refuzohet mbi bazën e rregullit 39 (2) të Rregullores së punës.
123. Në fund, Gjykata rikujton se, për sa i përket pretendimit të parashtruesve të kërkesës për shkelje të së drejtës së tyre për “mbrojtje gjyqësore të të drejtave” dhe “zgjidhje efektive” të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së [pretendimi i tretë], Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur asnjë argument se si kjo dispozitë kushtetuese në lidhje me atë të KEDNJ-së janë shkelur nga gjykatat e rregullta që kanë vendosur për kërkesëpadinë e tyre. Ata thjesht i kanë çekur këto nene dhe kanë kërkuar nga Gjykata që të gjejë shkelje të tyre, duke mos dhënë asnjë arsyetim përkatës për bazueshmërinë e pretendimeve të tyre.
124. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që vetëm citimi neneve të Kushtetutës apo të KEDNJ-së nuk mund të konsiderohet si përmbushje e detyrimit që rrjedh nga neni 48 i Ligjit në lidhje me pikën (d) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës ku kërkohet nga parashtruesit e kërkesës të qartësojnë *“saktësisht dhe në mënyrë adekuate [...] pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.”* Andaj dhe rrjedhimisht, në linjë me praktikën gjyqësore të kësaj Gjykate, kjo e fundit, pretendimin e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së nuk do e trajtojë më tutje duke qenë se parashtruesit e kërkesës nuk kanë qartësuar saktësisht pretendimin e tyre për shkeljen e këtyre dispozitave (shih, në këtë aspekt, Aktvendimet për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese – ku janë refuzuar pretendime të ngjashme: KIO2/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë]*, paragrafët 40-41 dhe KIO1/18, parashtrues *Njazi Gashi, Lirije Sadikaj, Nazife Hajdini-Ahmetaj dhe Adriana Rexhepi*, paragrafët 52-54).

Përfundime

125. Gjykata, si përfundim, vendos që:

- (i) Pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ përkitazi me arsyetim të vendimeve gjyqësore, mos-caktim të superekspertizës dhe aprovimi i kërkesës për disa dëshmitarë shtesë janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe si të tilla duhet të refuzohen si të papranueshme në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës;
- (ii) Pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ përkitazi me të drejtën e pronës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe si të tilla duhet të refuzohen si të papranueshme në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës;

- (iii) Pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ për sa i përket çështjes së mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe zgjidhjes efektive nuk janë të qartësuara në mënyrë adekuate dhe si të tilla duhet të refuzohen në bazë të nenit 48 të Ligjit në lidhje me rregullin 39 (1) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 39 (1) (d) dhe 39 (2) të Rregullores së punës, më 5 shkurt 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Mila Rama-Hajrizi

